



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 50/2 Prot

Tiranë, më 02.02.2022

Lënda: Kthim Përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj administruar në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKRTK), pas shqyrtimit, verifikimeve të kryera në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe Nenit 32 të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, lidhur me informacionin e kërkuar mbi pyetjet e parashtuara Ju informojmë si vijon:

Pyetje 1: Sa persona/entitetet janë të regjistruar në regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore?

Sqarime IKRTK: Në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” rezultojnë të regjistruar 1525 posedues.

Pyetje 2 : Sa prej tyre janë rrjete muzeore, galeri arti, persona privat, institucione të specializuara dhe bashkësi fetare?

Sqarime IKRTK: Në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” rezultojnë të regjistruar:

- 172 posedues shtetërore,
- 4 komunitete fetare,
- 1346 posedues privatë ,
- 16 galeri arti
- 53 muze.

Pyetje 3: Sa pasuri materiale dhe jo materiale? Si karakterizohen. Na specifikoni kategorizimin e tyre sipas tipologjisë. Sa kanë pronësi private, sa publike?

Sqarime IKRTK: Në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” rezultojnë të regjistruara 480615 pasuri materiale dhe 5 pasuri jomateriale.

Objektet janë të regjistruar sipas fushave: Arkeologji, Etnografi, Arkitekturë, Dokument Historik, Numizmatikë, Vepra Muzikore, Artet Pamore, Objekte Natyrore, Kinematografi

Pyetje 4: Si funksionon Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore?

Sqarime IKRTK: Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK) funksionon në bazë të VKM nr. 278, datë 16.5.2018 për “Krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore: Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore”, të cilën e gjeni bashkëlidhur.

Pyetje 5: Sa raste janë regjistruar në bazën e të dhënave për pasuritë kulturore të vjedhura. Na i specifikoni sipas tipologjisë.

Sqarime IKRTK: Referuar Regjistrimit Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK) rezultojnë të humbura ndër vite 2341 objekte, konkretisht sipas fushave:

- Arkeologji 272 objekte
- Etnografi 1808 objekte
- Numizmatikë 3 objekte
- Arte Pamore 258 objekte

Theksojmë se në 5 vitet e fundit rezulton i humbur vetëm 1 objekt që i përket fushës etnografi.

Pyetje 6: -Sa pasuri janë eksportuar me liçencë për qarkullimin ndërkombëtar?

Sqarime IKRTK: Aktualisht qarkullimi i pasurive kulturore kryhet vetëm me Urdhër Ministri, pasi jemi ende në proces hartimi të akteve nënligjore të cilat vëne në funksion Licencat për Importin dhe Eksportin e Pasurive kulturore

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Sokol MUÇA

